

Kraja në Kosovën Pas Krishtit

RIMINI - "Kosova, mbijetesa e një populli" është një nga botimet e fundit që i janë kushtuar Kosovës. Ajo ka për autor **Alban Krajen** dhe mendohet se me rastin e 28 nëntorit do të fillojë të publikohet në Rimini. Lajmi është publikuar dje, nga Shoqata "Iliria", asosacioni që përmbledh interesat e të gjithë shqiptarëve të Italisë. Për këtë libër është shfrytëzuar nga autori një literaturë shumë e gjërë. Ajo fillon nga biblioteka e Vatikanit më pas në Paris dhe pastaj në Pragë dhe në Vjenë. Ai ka rivërtetuar dhe nxjerrë fakte të tjera, që kanë lidhje me autorët më të shquar të historisë Botërore. Konkluzioni ku ka arritur autori dhe që ai është krenar me përfundimin e punës së tij është se: **Shqiptarët janë popull homogjen, më i lashti i Europës i cili sot e kësaj dite,**

ruan akoma sot një gjuhë e cila është vërtetuar që shkruhej që në shekullin e V-të para Erës Sonë.

Ajo që është e veçanta e këtij libri është se i është lënë një vend shumë interesant, Antikitetit të Kosovës. Sipas autorit në Kosovë është edhe merita e themelimit të Trojës së Lashtë, si edhe vendi ku kanë lindur shumë perandorë të Romës dhe Bizantit. Ai ka fokusuar për Kosovës kohën para vitit 1389, koha kur në Fushë-Kosovë ndodhi kthesa e madhe e popujve të Ballkanit në fitim të Perandorisë të madhe Otomane.

Alban Kraja vjet në Itali ka suksesuar me librin e tij "24 perandorë shqiptarë në udhëheqjen e Romës", i cili është shitur normalisht. Autori mendon që të sjellë në shqip librin e parë fillimisht dhe më vonë edhe librin e dytë. **b.an**